



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 9, datë 23.07.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË  
RREGULLOREN NR. 22, DATË 24.06.2011 “MBI KUSHTET TEKNIKE PËR  
NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETEVE KABLLORE URBANE  
DHE RRJETEVE ME FIBRA OPTIKE NDËRURBANE TË KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE” TË NDRYSHUAR**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),  
me pjesëmarrjen e:

|             |                       |                |
|-------------|-----------------------|----------------|
| <b>Z.</b>   | <b>Gentian Sala</b>   | <b>Kryetar</b> |
| <b>Znj.</b> | <b>Edlira Dvorani</b> | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Lorenc Bako</b>    | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Armer Juka</b>     | <b>Anëtar</b>  |

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 23 korrik 2025, në zbatim të procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues, e ndryshuar dhe ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” të ndryshuar

**BAZA LIGJORE:**

1. Pikat 1 të neneve 14 dhe 15, pika 1, (b) neni 35, nenet 57 dhe 58 i ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Pika 14, neni 3, neni 4, pika 5 e nenit 18 të ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”,

3. Rregullore e brendshme “Për funksionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me VKD nr. 7, datë 16.02.2017, e ndryshuar;
4. Rregullore nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” të ndryshuar

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shpjegues i projektvendimit, i përgatitur nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme
2. Projektvendimi i arsyetuar

## **V Ë R E N:**

AKEP, me vendimin e Këshillit Drejtues nr.1617, datë 24.06.2011 ka vendosur “Miratimin e rregullores mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” (Rregullore nr. 22, datë 24.06.2011), ndryshuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2575, datë 01.06.2015.

Kjo rregullore përcakton kërkesat teknike që duhet të përmbushen në zhvillimin, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe infrastrukturës së rrjeteve me Fibra Optike Ndërrurbane të Komunikimeve Elektronike. Rrjetet kabllore dhe rrjetet me fibër optike janë pjesë thelbësore e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe shërbejnë për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun e gjerë.

Në këtë dokument trajtohen teknikat e kryerjes së punimeve civile, karakteristikat dhe përmasat e përbërësve të kanaleve kabllore, përshkrimet përkatëse të materialeve të përdorura, dhe një shtojcë e veçantë për profilet ndërtimore të kanaleve, pushtave, instalimeve ajrore dhe aksesoreve përkatës.

Kjo Rregullore ka dalë në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe në legjislacionin në fuqi në fushën e veprimtarisë së ndërtimit, mbrojtjes së mjedisit dhe zbatimit të standardeve aktuale teknike.

Ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 për Urbanistikën, është shfuqizuar me ligjin nr. 10119/2009, i cili gjithashtu është shfuqizuar me ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit.

Rregullorja e miratuar në vitin 2011, e ndryshuar vendos kufizime duke ndaluar vendosjen e kabllave të telekomunikacionit në shtyllat elektrike të tensionit të lartë, ndërsa referuar ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” lejohet përdorimi i infrastrukturës fizike të rrjeteve elektrike për rrjetet e komunikimeve elektronike.

Ligji nr. 120/2016, ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë me kosto më të ulët, reduktimit të procedurave, si dhe sigurimit të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë. Ky ligj përcakton kërkesat minimale në

lidhje me punimet civile dhe infrastrukturën fizike, me qëllim harmonizimin e aspekteve ligjore e rregullatore dhe të procedurave administrative në këto fusha.

Në nenin 4 të këtij ligji parashikohet e drejta për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese, duke përcaktuar se: *“1. Çdo operator rrjeti ka të drejtë t’u ofrojë sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike akses në infrastrukturën e tij fizike, me qëllim vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë. ... 3. Çdo operator rrjeti duhet të vlerësojë mundësinë e plotësimit të kërkesës për akses në infrastrukturën e tij fizike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlerësimi bëhet mbi bazën e trajtimit në kushte të drejta, duke përfshirë çmimin, me qëllim zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”*

Referuar pikës 14, neni 3 të këtij ligji, operator rrjeti është një sipërmarrës që ofron ose është i autorizuar të ofrojë rrjete të komunikimeve publike, sipas ligjit për komunikimet elektronike, si dhe çdo sipërmarrës që ofron infrastrukturë fizike të destinuar për ofrimin e: ... i) gaz ii) energjisë, përfshirë edhe ndriçimin publik ....; Operator rrjeti do të konsiderohet bashkia, si dhe çdo subjekt juridik publik ose shtetëror që ka në pronësi apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, që mundësojnë vendosjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.

Pika 5 e nenit 18 të ligjit nr. 120/2016 parashikon se: *“Ndërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike duhet të kryhet duke respektuar rregullat për kushtet teknike të miratuara nga AKEP”*.

Sipas nenit 58 të ligjit nr. 54/2024 *“1. Kur një sipërmarrës i komunikimeve elektronike ushtron të drejtën në bazë të këtij ligji ose të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, për të instaluar facilitete në, mbi ose nën pronën publike ose private ose ka përfutur nga një procedurë për shpronësimin ose shfrytëzimin e pronës, AKEP-i vetë ose, sipas rastit, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente, siç specifikohen në nenin 3 të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, imponojnë bashkëvendosjen dhe bashkëpërdorimin e elementeve të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese të instaluara mbi këtë bazë për të mbrojtur mjedisin, shëndetin publik, sigurinë publike ose për të përmbushur objektivat e planifikimit urban”*.

Sa më sipër, është i nevojshëm miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren nr.22/2011, për t’a sjellë përmbajtjen e saj në harmoni dhe përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 120/2016, sa i përket të drejtës së përdorimit të infrastrukturës së rrjetit elektrik.

Konkretisht, neni 25 i rregullores parashikon kërkesa të përgjithshme për instalimet e rrjeteve kabllore në zonat urbane. Pika 25, germa b, përcakton:

*“..Shmangia nga linjat elektrike të tensionit të lartë, sidomos nga ecjet paralel për një distancë të madhe (mbi 500 metra);... “*

Neni 26 Kalimi i kanaleve kabllore në afërsi të linjave elektrike të TN dhe TU 26.1, parashikon:

*“26.2 Për të mënjeluar efektet e dëmshme si me sipër, infrastruktura për ndërtimin e rrjetit kabllor urban projektohet sa më larg linjave të transmetimit të energjisë, duke evituar kalimet e gjata paralele me ato të tensionit të lartë. Në rastet e kryqëzimit me njëra-tjetrën, synohet që këndi i ndërprerjes të jetë 90 gradë dhe në pamundësi, në çdo rast duhet të jetë më i madh se 45 gradë.”*

Neni 32 i rregullores parashikon rregullat për ndërtimin e infrastrukturës për rrjetet e

komunikimet elektronik me kabëll ajrore. Sipas pikave 32.6/b 32.7 dhe 32.8 të saj:  
“32.6 ... b. Për të mënjeluar efektet e dëmshme të mësipërme, rrjeti telefonik kabllor urban vendoset sa më larg linjave të transmetimit të energjisë, duke evituar kalimet e gjata paralele me ato të tensionit të lartë. Në rastet e kryqëzimit me njera tjetrën, duhen zbatuar kërkesat sipas Paragrafit 26.2 .

...

32.7 Ndalohet kategorikisht mbështetja e troseve dhe e kabllave ajrore me çfarëdo lloji mbulese në shtyllat elektrike të çdo tensioni.

32.8 Ndalohet kategorikisht vendosja e kabllave ajrore me çfarëdo lloji mbulese në të njëjtin tros mbajtës ku janë prezente linja të çdo lloji tensioni elektrik ...”

Po ashtu, në nenin 1, të rregullores parashikohen kërkesat/kushtet teknike dhe standardet që duhet të përmbushen në zhvillimin, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndërrbane të Komunikimeve Elektronike.

Sipas pikës 1.10 të rregullores “Të gjitha standartet e tjera të përdorur të cilët nuk janë të përfshira në këtë rregullore duhet të jenë konform standarteve të ITU në rekomandimet e Serisë L: “Construction, Installation and Protection of Cables and Other Elements of Outside Plant” dhe në këtë pikë do të përfshihen edhe standartet e përcaktuara në rekomandimet e Serisë G.600-G.699: “Transmission media and optical systems characteristics”, të cilat përcaktojnë karakteristikat teknike të ndërtimit të infraskuturës me fibrë optike.

Për shkak të shfuqizimit të akteve ligjore mbi të cilat është bazuar kjo rregullore propozohet edhe referimi në kuadrin ligjor në fuqi. Ligji nr.9918/2008, të zëvendësohet me ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe të hiqet referenca e ligjit Nr.8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, tashmë i shfuqizuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikat 1 të nenit 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrbane të komunikimeve elektronike” të ndryshuar, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

|                     |                       |                    |                                      |                   |
|---------------------|-----------------------|--------------------|--------------------------------------|-------------------|
| <b>Kryetar</b>      | <b>Anëtar</b>         | <b>Anëtar</b>      | <b>Anëtar</b>                        | <b>Anëtar</b>     |
| <b>Gentian Sala</b> | <b>Edlira Dvorani</b> | <b>Lorenc Bako</b> | <b>Bleron Dokle<br/>(Në mungesë)</b> | <b>Armer Juka</b> |

## PROJEKTI RREGULLORE

### “PËR

### MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 22, DATË 24.06.2011 “MBI KUSHTET TEKNIKE PËR NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETEVE KABLLORE URBANE DHE RRJETEVE ME FIBRA OPTIKE NDËRURBANE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE” TË NDRYSHUAR

#### Neni 1

1.1 Paragrafi 2 i nenit 1 të rregullores ndryshon si më poshtë:

*“Kjo rregullore bazohet në ligjin nr. 54/2024, datë 19.5.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ligjin nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” dhe në legjislacionin në fuqi në fushën e veprimtarisë së ndërtimit, mbrojtjes së mjedisit dhe zbatimit të standardeve aktuale teknike.*

#### Neni 2

Pika 1.10 e nenit 1 të rregullores ndryshon si më poshtë:

*“1.10. Të gjitha standardet e tjera të përdorura të cilët nuk janë të përfshira në këtë rregullore duhet të jenë konform standardeve të ITU në rekomandimet e Serisë L: “Construction, Installation and Protection of Cables and Other Elements of Outside Plant” dhe standardeve të ITU në rekomandimet e Serisë G.600-G.699: “Transmission media and optical systems characteristics”.*

#### Neni 3

*Germa “b”, në pikën 25.3 të nenit 25, pika 26.2 e nenit 26, germa “b” në pikën 32.6, pika 32.7 dhe 32.8 të nenit 32 të rregullores, si dhe çdo parashikim i rregullores që përcakton ndalesa për përdorimin e shtyllave elektrike të çdo tensioni, shfuqizohet.*

#### Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.